



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 1781/1 Prishtinë 30.05. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Agona Ramaj ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ Modelimi dhe analiza jo lineare e strukturave të pa armuara murature ” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakt

Ndërtesat me muraturë zënë një vend të konsiderueshëm në ndërtimet ekzistuese, të cilat janë ndërtuar në periudha të ndryshme kohore.

Numri i madh i objekteve ekzistuese me strukturë “sistem me mure mbajtëse” dhe veçanërisht në vendet me sizmitet të lartë, shpjen në kërkesën për zgjerimin e nivelit të njohurive, me qëllim të vlerësimit të rezistencës së tyre dhe kapacitetit mbajtës kjo për arsye të njohura të objekteve muraturë si shumë vulnerabil si dhe të vlerësojnë kapacitetin sizmik dhe reagimin e objekteve të reja dhe ekzistuese gjatë një ngjarje sizmike.

Modelimi i muraturës për shumë kohë ka qenë gjithashtu një sfidë për inxhinierët dhe shkencëtarët. Kjo për arsye të sjelljes komplekse të saj e vetive jo të njëjta mekanike të tyre në drejtime të ndryshme.

Synimi i këtij punimi është studimi i sjelljes së strukturës muraturë duke u bazuar në EC-6 si dhe EC-8, nxjerrja e rezultateve nën reagimin sizmik dhe krahasimi i zhvendosjeve të ndodhura me ato të projektuar.

Analiza jolineare statike është bërë së fundmi një nga metodat më të përdorshme, për projektim dhe vlerësim të performancës sizmike të ndërtesave, për shkak të thjeshtësisë dhe praktikitetit të saj.

Ky punim i diplomës kryesisht trajton analizen e një strukture muraturë me mure të pa armuara disa kate e cila ka rregullsi strukturore.

Për llogaritjen e një strukture të një objekti prej murature, do të shfrytëzohet analiza “pushover” duke shfrytëzuar programin ETABS. Me këtë analizë, për objektin, përkatësisht strukturën krijohet një model matematikor me ngarkim horizontal deri në shkatërrim.

Bazuar në teorinë e performancës sizmike, procedurat jolineare statike lejojnë vlerësimin e performancës dhe dëmtimeve nën veprimin e forcës sizmike.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.